



UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË

Kryesues i Senatit
Prof. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 2666 Dt 01.11.2022

Senati i Universitetit "Isa Boletini", në Mitrovicë, në mbledhjen e mbajtur më 31.10.2022, mori:

VENDIM

- I. Anulohet pjesërisht konkursi Për emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në fakultetet e Universitetit "Isa Boletini", i datës 08.07.2022.
- II. Anulimi i konkursit të shpallur më 08.07.2022, do të bëhet për këto pozita:
Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike
 1. Për pozitën "Një mësimdhënës për lëndët: Mekanikë e fluideve, Fluidodinamikë, Bazat e prodhimit të energjisë, Termodinamikë, Sistemet hidraulike dhe pneumatike dhe Menaxhimi i sistemeve të energjisë".
 2. Për pozitën "Një mësimdhënës për lëndët: Detalet e makinave I, Detalet e makinave II dhe Materialet e reparit".
 3. Për pozitën "Një mësimdhënës për lëndët: Grafika inxhinierike, Standartizimi dhe legjislatura industriale, Përpunim me prerje I, Përpunim me prerje II dhe Metodatat jokonvencionale të përpunimit".

Arsyetim

Anulimi i konkursit për pozitat nga pika II bëhet për arsye se:

Në **Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike**, për pozitën "Një mësimdhënës për lëndët: Mekanikë e fluideve, Fluidodinamikë, Bazat e prodhimit të energjisë, Termodinamikë, Sistemet hidraulike dhe pneumatike dhe Menaxhimi i sistemeve të energjisë", për shkak se për këtë pozitë ka konkuruar vetëm kandidati prof. ass. dr. Fisnik Osmani. Mbështetur në Vendimin nr. 2168 dt. 30.09.2022, kandidatit i është ndërprerë marrëdhënia e punës në UIBM, dhe i njejt i nuk ka të drejtë as të rigjedhet e as të avancohet, ndërsa për pozitat "Një mësimdhënës për lëndët: Detalet e makinave I, Detalet e makinave II dhe Materialet e reparit" dhe për pozitën "Një mësimdhënës për lëndët: Grafika inxhinierike, Standartizimi dhe legjislatura industriale, Përpunim me prerje I, Përpunim me prerje II dhe Metodatat jokonvencionale të përpunimit", nuk ka aplikuar asnjë kandidat.

Bazuar në këto që u cekën, Senati mori vendim si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi t'i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it;
2. Fakulteteve;
3. Zyrës për informim me publikun

Prof. dr. Alush Musaj

Kryesues i Senatit

